



MISIONI  SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Shtiracakë


19 Tetor 2014



Në atë kohë, farisenjtë u ndanë në një anë dhe u këshilluan si ta zënë gabim në fjalë. Dërguan nxënësit e vet bashkë me herodianë për t'i thënë: “Mësues, ne e dimë se ti gjithmonë flet të vërtetën dhe se me të vërtetë e mëson udhën e Hyjit pa marrë parasysh kush është kush: ti nuk këqyr ç’pozitë kanë njerëzit! Na thuaj, pra, si mendon ti: a është e lejueshme t’i paguhet Cezarit tatim apo jo?” Jezusi, duke e njohur mirë djallëzinë e tyre, tha: “Shtiracakë, pse po më sprovoni? Ma tregoni monedhën e tatimit!” Ata ia sollën një denar. “E kujt është – u tha – kjo fytyrë e ky mbishkrim?” “E Cezarit!” – i përgjigjën ata. Atëherë Jezusi u tha: “Jepni, pra, Cezarit çka i përket Cezarit, e Hyjit çka i përket Hyjit.” *Mt 22, 15-21*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com ose kunsultoharten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

23 Tetor Shen Gjon Kapistrani
24 Tetor Shen Anton Maria Klaret

Aktivite te ardhshme...

Me 28 nentor, festa e Flamurit, Kisha jone do te kete nje party te salla e kishes ne Browns Line.

Keshilli i Kishes...

Te dielen 9 nentor do te kemi votimin e per Keshillin e ri te Kishes.

Bekimi i shtëpisë dhe i familjes...

Kush deshiron ti bekohet shtepia dhe familja te kontaktoje me famullitarin ne numrat e Misionit Katolik Shqiptar, per te koordinuar ditën dhe orarin.

Hakun e Kishes per vitin 2014

e kane dhene **Vasel Dreshaj, Ilir Gjokaj:**

Agron	Markaj	Lekë	Kapllaj
Aleks	Coku	Leks	Dragu
Altin	Miri	Luigj	Narkaj
Angjelin	Kaçaj	Luk	Gjolaj
Anton	Brunga	Marash	Martinaj
Anton	Malaj	Marin	Muzhani
Anton	Tinaj	Mario	Martini
Arben	Marku	Mark	Shkreli
Arben	Toma	Martin	Pjetri
Arben	Pepa	Mhill	Ftoni
Ardian	Preçetaj	Ndok	Macaj
Arjana	Nati	Ndue	Cacaj
Astrit	Simeqi	Nik	Biçi
Aurel	Vata	Nush	Kacaj
Beniamin	Hasko	Nush	Dokaj
Dod	Ndreu	Paulin	Lukani
Edmond	Kacorri	Paulin	Marku
Eduard	Shkreli	Petrit	Ujka
Erion	Tase	Pjerin	Kalaj
Flobenc	Shkalla	Pjeter & Bep	Dreshaj
Gac	Gjoka	Prek	Frani
Gezim	Lanazi	Prek	Lekaj
Gjergj	Nikolla	Prek	Spaçi
Ilir	Gjokaj	Prek	Kaçaj
Ladi	Lumaj	Preke	Gjonaj
Lekë	Tarazhi	Roza	Kalaj

Rrok	Gjoni	Vaso	Gjuravcaj
Sander	Kosmaci	Viktor	Pleti
Sokol	Ujka	Viktor	Gjokaj
Sokol	Gashaj	Vitor	Mernacaj
Tom	Ulaj	Vladimir	Doda
Ton	Vocaj	Zef	Deklaj
Valmir	Gjinaj	Zef	Lulaj
Vasel	Dreshaj		

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Me 19 tetor kujtojmë përvjetorin e lumnimit të Nënës sonë Terezë



Sot me 19 tetor kujtojmë përvjetorin e lumnimit të Nënës sonë Terezë, Gonxhe Bojaxhiut në Vatikan nga Papa Shën Gjon Pali II. Me 19 tetor 2003, në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan

të mbushur përplot me shqiptarë të ardhur nga të gjitha viset, së bashku me qindra mijëra shtegtarë të ardhur nga mbarë bota, Papa Shën Gjon Pali II e shqiptoi formulën kanonike të Kishës që e lartonte Nënën e Madhe të të varfërve të mbarë botës, në nderimet e elterit. Ta dëgjojmë çastin kulmor, shqiptimin e **FORMULES SE LUMTURIMIT nga Papa Gjon Pali II atë ditë të paharrueshme: “Ne, duke përmbushur dëshirën e Vëllait tonë Lukas Sirkar, Kryeipeshkëv i Kalkutës, si dhe të shumë vëllezërve të tjerë në Episkopat e edhe të shumë besimtarëve, pasi kemi marrë mendimin e Kongregatës për Çështjet e Shenjtërve, me Autoritetin Tonë Apostolik pranojmë që Shërbëtorja e nderuar e Hyjit, Tereza e Kalkutës, tani e tutje të quhet “E Lume” e që festa e saj të kremtohet në vendet e sipas rregullave të caktuara nga e drejta kanonike, çdo vit, në ditën e lindjes së saj për qiell, më 5 shtator”.** Sot pra, me 19 tetor, nuk është festa liturgjike kishtare e së Lumes Nënë Terezë, por Festa Kombëtare e Saj, sepse kjo ditë, me të drejtë, u shpall festa e të gjithë shqiptarëve, për të cilët Nënë Tereza tani ndërmjetëson nga qielli, ndërsa vijon të na kujtojë se: **“Jezusi erdhi të na sjellë Lajmin e Mirë se Zoti na do e se ne duhet ta duam njëri-tjetrin, ashti Ai na do ne. Po ku e ka fillimin dashuria? Në familje. Si fillon? Duke iu lutur së bashku Zotit. Familja që lutet së bashku, mbetet e bashkuar. E nëse ju do të mbeten të bashkuar do ta doni e respektoni njëri-tjetrin, ashtu si Jezusi ju do.**





DECREE

In order to provide for the administration of justice in the Archdiocese of Detroit, I hereby appoint Reverend Kemal Giovanni Kokona, JCD, as a Judge of the Metropolitan Tribunal in First and Second Instance in accord with canons 1421 and 1422. The exercise of this office shall be carried out according to the norms of universal and particular law.

This appointment shall remain in effect until June 30, 2019, or until such time as it is revoked by me or my successors.

Given at Detroit on October 7, 2014.


The Most Reverend Allen H. Vigneron
Archbishop of Detroit


Ecclesiastical Notary

Çojeni pra lutjen, gëzimin, dashurinë e paqen në familjet tuaja e kështu do të rriteni në shenjtëri. Shenjtëria nuk është luks për pak vetë, është një bukuri e thjeshtë, sepse Jezusi ka thënë: “Jini të shenjtë, ashtu si Ati im që është në qiell”. Zoti ju bekoftë të gjithëve”. E duke shfletuar kujtesën tonë historike i dëgjojmë përsëri zërat e shqiptarëve të cilët, nga Sheshi i Shën Pjetrit në Vatikan, shprehen emocionin e thellë të atij çasti kur, si rrallëherë, mbarë bota përsëriste me nderim të thellë emrin e kombit shqiptar, që kishte nxjerrë nga gjiri i vet atë që Papa Shën Gjon Pali II e përshkoi gjatë kremtimit të lumturimit të 19 tetorit të vitit 2003 si figurë simbolike të misionit të Kishës, duke shtrënguar, me njëren dorë, atë të një fëmije e, me tjetrën, Ruzaren Shenjte. Kundrim e veprim, ungjillëzim e përparim njerëzor: Nënë Tereza e kumtoi Ungjillin me jetën e saj të cilën ua dhuroi plotësisht të varfërve, e njëkohësisht, lutjes- pati thënë Shën Gjon Pali II. Në përfundim të këtij përkujtimi, ti bëjmë tonat fjalët e

Papës Vojtila për të Lumen Nënë Terezë, shqiptuar në homelinë e Meshës së Lumturimit të saj në Vatikan me 19 tetor 2003: **“Ta lavdërojmë këtë grua të vogël, të dashuruar me Zotin, këtë lajmëtare të përvuajtur të Ungjillit e bamirëse të palodhur të njerëzimit. Në të nderojmë një nga personalitetet më të rëndësishme të epokës sonë. Ta pranojmë mesazhin ta ndjekim shembullin e saj”.** Le të vazhdojmë ta ndjekim shembullin e saj e të jemi mjete të dashurisë hyjnore.

Sutton
SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE

Miranda Bimo
Sales Representative

Bus: 416.240.1000
Cell: 647.294.8826
Fax: 416.240.1603

300-5415 Dundas St. W.
Toronto ON, M9B 1B5

mirandabimo@gmail.com

Rocco C Lofranco L.L.B.
The Madison Centre
4950 Yonge Street Suite 600
Toronto ON M2N 6K1

416 223 8333
Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton

LOFRANCO CORRIERO
PERSONAL INJURY LAWYERS

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Gera Shtepi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethina)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.
* Call for Details

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre

KODRA
TM



Produkte Shqiptare!
Prodhuar dhe importuar nga Shqiperia.

- Fergese
- Reçel fiku, pjeshke, kumbulle, qershie
- Marinade Speci, kastravec, lakre
- Specat e pjekur
- Specat djeges
- Panxhar i kuq
- Komposto kumbulle
- Uje Mineral Tepelene
- Coffee Skenderbeu



www.kodra.org

Kramer's Bar & Grill
1915 Yonge St Toronto
Per Festa Private
Kontakto Arben Toma
Tel : 647-887-9058

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA, CGA

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com